



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Bazuar në:

- Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) të dhëna me Nenin 14.2 dhe Nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr.034/L-185;
- Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë;
- Kërkesën e Ngrohtores së Qytetit Gjakova Sh.A (N.Q Gjakova Sh.a) për derogim (shtyrje afati) në zbatimin e disa dispozitave të Licencave të N.Q Gjakova Sh.a-së, të datës 02 nëntor 2010,

në seancën e mbajtur me datë 22 dhjetor 2010, nxori këtë:

VENDIM

- I. LEJOHET** N.Q Gjakova Sh.a derogimi (shtyrje afati) në zbatimin e disa neneve dhe dispozitave të Licencave të Gjenerimit, Operimit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizimit Publik me Ngrohje Qendrore, si në shtojcën e bashkangjitur këtij vendimi.

Arsyetim

- o N.Q Gjakova, me datë 02.11.2010 në pamundësi të përmbushjes së disa dispozitave të neneve të Licencës për Gjenerim, Shpërndarje dhe Furnizim me Ngrohje Qendrore, i është drejtuar Bordit të ZRRE-së për shtyrje afati deri në përmirësimin e kushteve për plotësimin e këtyre dispozitave.
 - o Zyra e Rregullatorit për Energji pas disa ndërhyrjeve në këto kërkesa dhe udhëzimeve të dhëna përfaqësuesve të N.Q Gjakova, përfundimisht me datë 21.12.2010 ka pranuar kërkesën për shtyrje afati të disa dispozitave të neneve të licencave.
 - o ZRRE ka vlerësuar kërkesën për derogim të N.Q Gjakova dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
 - o Afatet e lejuara për shtyrje afati janë si në tabelën më poshtë.
- II.** Të gjitha Nenet dhe dispozitat tjera të licencës së N.Q Termokos Sh.a-së mbesin në fuqi.
- III.** Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente, brenda katërmëdhjetë (14) ditëve, nga data e pranimet të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bashkangjitur - Shtojca me Derrogimet e lejuara

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Përparim Kabashi, anëtar

Theranda Beqiri, anëtare

Blerim Koci, anëtar



Licenca për Gjenerim të Ngrohjes Qendrore

Nr	Neni	Derogim i datës 15.08.08 deri me:	Derogim i datës 27.05.09 deri me:	Derogim i datës 24.03.10 deri me:	Derogim i datës 10.09.10 deri me:	Derogim i datës 22.12.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2.2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Gjenerimit të energjisë termale	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
2.	Neni 5-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	-	30 qershor 2011	
3.	Neni 8 - Mjedisi	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	
4.	Neni 11 - Obligimi i Sigurimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	30 qershor 2011	

Licenca për Operator të Sistemit të Shpërndarjes së Ngrohjes Qendrore

Nr	Neni	Derogim i datës 15.08.08 deri me:	Derogim i datës 27.05.09 deri me:	Derogim i datës 24.03.10 deri me:	Derogim i datës 10.09.10 deri me:	Derogim i datës 22.12.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Shpërndarjes	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
2.	Neni 4-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	-	30 qershor 2011	
3.	Neni 5-Detyrimet e të Licencuarit lidhur me pajisjet matëse	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
4.	Neni 6-Kyçja në Rrjetin e Shpërndarjes së Ngrohjes (Metod.e Tarifave për Kyçje)	-	-	-	-	30 qershor 2011	
5.	Neni 12.1-Standardet e Sigurisë së Sistemit të Shpërndarjes dhe Planifikimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	30 qershor 2010	31 dhjetor 2010	31 mars 2011	
6.	Neni 13-Standardet e Përbushjes së Biznesit të Operimit të Sistemit të Shpërndarjes	-	-	-	-	30 qershor 2011	
7.	Neni 18-Shëndeti dhe Siguria	-	-	-	-	31 mars 2011	

Licenca për Furnizim Publik me Ngrohje Qendrore



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGIJ
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Nr	Neni	Derogim i datës 15.08.08 deri me:	Derogim i datës 27.05.09 deri me:	Derogim i datës 24.03.10 deri me:	Derogim i datës 10.09.10 deri me:	Derogim i datës 22.12.10 deri me:	Koment nga ZRRE
1.	Neni 2- Llogaritë e Ndara për Biznesin e Furnizimit	31 dhjetor 2008	30 shtator 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
2.	Neni 5-Pajtueshmëria me kodin e shpërndarjes, kodin matës dhe RRPFE*	31 dhjetor 2008	31 dhjetor 2009	31 shtator 2010	-	30 qershor 2011	
3.	Neni 7.4-Qeverisja e Detyrimeve të të Licencuarit	-	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
4.	Neni 8-Furnizimi me Njehsorë	-	31 dhjetor 2009	31 dhjetor 2010	-	30 qershor 2011	
	*RRKPFE	Rregulli mbi Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji					